

KPA Nr. 001 – Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet – 2020

Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

PYETJE TË SHPESHTA

1. Thirrja për grante të vogla - qeverisja lokale, a është e hapur për aplikim vetëm për organizatat jo qeveritare apo edhe për grupet jo formale?

Thirrja është e hapur për: Këshillat rinore lokale për këshillëdhënie, OJQ-të lokale, grupe që kanë për bazë komunitetet dhe çështje të ngjashme, subjekte të sektorit privat, organizata të shoqërisë civile dhe mediat. Aplikantët duhet të jenë subjekte të regjistruara ligjërisht. Institucionet komunale dhe institucionet e tjera publike (p.sh. shkollat publike, spitalet, universitetet) nuk mund të aplikojnë për këto grante në mënyrë të drejtpërdrejt, por entitetet që kanë mundësi të aplikojnë inkurajohen fuqishëm t'i përfshijnë të njëjtat si partnere.

2. A ka mundësi të jetë përfituese edhe një organizatë joqeveritare e cila merret me trajnime, dhe ka kryesisht karakter lokal – regjional dhe ka nevojë për pajisje kryesisht kompjuterike.

Një organizatë qeveritare e cila merret me trajnime mund të aplikojë për grante në kuadër të CCA sipas fushave relevante të përcaktuara në thirrjen për grante. Pajisje kompjuterike apo të tjera, nuk mund të blihen me fondet e këtyre granteve.

3. Cilat fusha dhe profile të projekteve i mbështesni?

Aktivitetet që financohen nga CCA përmes granteve duhet të jenë në përputhje me kriteret e përgjithshme si në vijim:

- Të promovojnë objektivat e përgjithshme të CCA dhe të kontribuojnë në katër rezultatet e lartë përmendura.
- Mund të trajtojnë një numër temash, përfshirë këtu pjesëmarrjen demokratike, artin dhe kulturën, sportin, zbutjen e varfërisë, ruajtjen e kulturës, çështjet mjedisore, arsimimin, të kuptuarit e mediave dhe tema të tjera që kontribuojnë në objektivat strategjike të CCA dhe në katër rezultatet e pritshme. Të gjitha iniciativat që do të mbështeten përmes këtyre granteve duhet të kenë rezultate të matshme dhe të jenë në përputhje me katër rezultatet e CCA.
- Zhvillimi i aktiviteteve të grantit duhet të bëhet në Kosovë dhe me përfitues Kosovarë.

4. A duhet që edhe OJQ të aplikojnë për DUNS sepse sipas asaj që pamë në website të tyre numri DUNS ipet për biznese?

OJQ-të duhet të paraqesin numrin e tyre DUNS, dhe numri DUNS nuk është vetëm për biznese. Ju lusim përcjellni Udhëzimet për t'u pajisur me numrin DUNS në këtë link: <https://dplus.org/grantet/>

5. Në çfarë gjuhe duhet të dërgohet aplikacioni?

Aplikacioni mund të shkruhet në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Pakot e aplikimit në të tri gjuhët mund t'i gjeni në ueb faqe të Democracy Plus në këtë link: <https://dplus.org/grantet/>

6. A duhet vetëm të plotësojmë dokumentin me të gjitha detajet për projektin tonë?

Dokumentet të cilat duhet të plotësohen janë: Formulari për Aplikim dhe Formulari për Buxhet. Këto dy dokumente mund t'i gjeni në ueb të Democracy Plus në këtë link:

7. Do të donim të dinim diçka më tepër rreth grantit: buxheti minimal për të cilin mund të aplikojmë, buxheti më i lartë i mundshëm, propozimet për aktivitetet dhe procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen e aplikacionit?

Buxheti minimal siç është e cekur edhe në Kërkesën për Aplikim, është 5,000 USD, ndërsa ai maksimal është 15,000 USD. Aktivitetet i propozoni ju në Formularin e Aplikimit.

Pakoja e aplikimit duhet të përfshijë:

- Formularin e plotësuar të aplikimit;
- Buxhetin e parashikuar dhe arsyetimin e buxhetit;
- CV-të e punonjësve kyç të projektit;
- Kopjen valide të certifikatës së regjistrimit në Kosovë;
- Kopjen e statutit të organizatës;
- Numrin fiskal.

Aplikacionet duhet të dërgohen vetëm në mënyrë elektronike në email adresën: grants@dplus.org. Afati i fundit për ta dorëzuar aplikacionin është **21.10. 2020, ora 17:00.**

8. Sa është afati i implementimit të projektit?

Afati i implementimit të projektit është 10 muaj.

9. Më shume informata mbi numrin DUNS dhe si merret ai.

Ju lusim përcjellni Udhëzimet për t'u pajisur me numrin DUNS në këtë link: <https://dplus.org/grantet/>

10. Cilat janë kërkesat për të fituar grantin me vlerë 5000 dhe 15000?

Vlera e grantit përcaktohet në bazë të aktiviteteve të propozuara nga aplikantët.

11. Kur pritet të fillojë dhe përfundojë projekti?

Projektet pritet që të fillojnë gjatë muajit nëntor 2020, dhe kohëzgjatja e tyre nuk duhet të jetë më shumë se 10 muaj.

12. A duhet që projekti të shkruhet në anglisht apo shqip?

Aplikacioni mund të shkruhet në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Paket e aplikimit në të tri gjuhët mund t'i gjeni në ueb të Democracy Plus në këtë link: <https://dplus.org/grantet/>